

Shtyhet Thirrja për Bursa për Stafin Akademik në Programin Erasmus + në Universitetin e Graz-it, në Austri, për semestrin e dytë të vitit akademik 2016-2017.

Në kuadër të programit Erasmus + shtyhet thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për stafin akademik të Universitetit të Tiranës në Universitetin e Graz-it, në Austri, për semestrin e dytë të vitit akademik 2016-2017.

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

-Shkëmbimin e stafit akademik për mësimdhënie;

Kohëzgjatja e bursave:

-Shkëmbimi i stafit akademik për mësimdhënie (5 ditë + 2 ditë udhëtim); Mobiliteti duhet të zhvillohet brenda semestrit të dytë të vitit akademik 2016-2017, deri më korrik 2017.

Fushat e studimit:

Për tu njohur me fushat e studimit që ofron Universiteti i Graz referohuni në këto adresa:

https://online.uni-graz.at/kfu_online/wbENLVSuche.wbEnLvSuchePage

https://online.uni-graz.at/kfu_online/webnav.ini

http://static.uni-graz.at/fileadmin/bib/downloads/studierende/incoming/ugo/bibwww_s_ugo_guidelines.pdf

Bursat përfshijnë:

-Kompensimin ditor (140 EUR në ditë për stafin);

-Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës);

DISTANCA E UDHËTIMIT (http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)	Kompensimi
Midis 100 dhe 499 KM	180 EUR
Midis 500 dhe 1999 KM	275 EUR
Midis 2000 dhe 2999 KM	360 EUR
Midis 3000 dhe 3999 KM	530 EUR
Midis 4000 dhe 7999 KM	820 EUR
8000 KM ose më shumë	1100 EUR

Për të përcaktuar distancën ju lutem referohuni në këtë link:

http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm

Dokumentat e nevojshme për aplikim për **stafin akademik**:

-CV+ lista e publikimeve (në gjuhën angleze);

-Kopje e Pasaportës;

-Certifikata e gjuhës së huaj në nivelin B2 të gjuhës angleze ose gjermane nëvarësi të programit të mësimdhënies;

-*Plani i mobilitetit;

-Vërtetim punësimi;

-Letër Ftese (Aplikantët duhet të kontaktojnë me një koleg në Universitetin e Graz-it duke i dërguar një CV dhe Planin e Mobilitetit në mënyrë që të pajisen me një ftesë prej tij për të plotësuar dosjen e aplikimit. Për të gjetur kontaktet e pedagogëve në Universitetin e Grazit ju lutem vizitoni adresën

<http://www.uni-graz.at/en/university/information/faculties/> ose mund të kontaktoni me Z. Blaž Ploj (blaz.ploj@uni-graz.at) për t'ju ndihmuar në gjetjen e kontakteve.

**Plani i Mobilitetit për stafin akademik është një dokument në të cilin duhet të specifikohet programi juaj i propozuar që do të kreyntë gjatë periudhës së shkëmbimit. Ky dokument firmoset nga aplikanti dhe nga personi përgjegjës në Rektorat i cili është Koordinatori Institucional i Erasmus +, Z. Elton Skendaj.*

Për të shkarkuar formatin e Planit të Mobilitetit vizitoni:

http://www.unitir.edu.al/images/dokumenta/Test/2-staff_mobility_agreement_teaching_partner%20prot.doc

Afati për aplikime: 20 Mars 2017

Dokumentacioni duhet dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Drejtoria e Komunikimit, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë si edhe të skanuara në adresën iro@unitir.edu.al

Për më shumë informacion mbi bursat mund të kontaktoni me Sektorin për Marrëdhëniet me Jashtë në adresën e e-mail: iro@unitir.edu.al

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikimin tuaj!